



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KËSHILLI I BASHKISË MEMALIAJ

Nr. 018/2 prot.

Memaliaj më 30.03.2026

Procesverbal

I mbajtur sot më datë 30.03.2026 në sallën e mbledhjeve në katin e parë të bashkisë Memaliaj.
Ora e fillimit të mbledhjes 10:00.

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e fillimit të mbledhjes 9 Këshilltarë.

Kryesuesi i mbledhjes Z. Erjon Sinanaj/ Kryetar.

Njihen këshilltarët me rendin e ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 27,02.2026.
3. Informacion mbi vendimet e datës 27,02.2026.
4. **Analizë nga Sektori i Emergjencave Civile pranë Bashkisë:** "Raportim mbi përballimin e emergjencave gjatë vitit 2025 si dhe masat e marra për vitin 2026".
5. **Drejtoria e financës:** "Raportim mbi realizimin e buxhetit të vitit 2025".
6. **Auditi i brendshëm:** Raporti i auditimit për vitin 2024.
7. **Projekt vendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike (fondi i kushtëzuar 6% i bllok-ndihmës ekonomike) për muajin shkurt 2026".

Komisioni për shqyrtim: Komisioni i mirëqenies sociale.

8. **Projekt vendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin mars 2026".

Komisioni për shqyrtim: Komisioni i mirëqenies sociale.

9. **Projekt vendim:** "Për miratimin e marrjes me qera të një ambienti për shërbime në funksion të të moshuarve".

Komisioni për shqyrtim: Komisioni i mirëqenies sociale.

10. **Projekt vendim:** "Për miratimin e një ndryshimi në buxhetin e vitit 2026".

Komisioni për shqyrtim: Komisioni i ekonomisë.

11. **Projekt vendim:** "Për miratimin e planit të integritetit të bashkisë Memaliaj 2026 – 2028"

Komisioni për shqyrtim: Komisioni i integritetit evropian.

12. **Projekt vendim:** “Për dhënie ndihmë financiare Z.Sokol Lulo”.
13. **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës financiare për Z.Laert Kasemi”.
14. **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës financiare për Znj.Idajete Dedgjoni”.
15. **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës financiare për Z.Filip Çoka”.
16. **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës financiare për Znj.Elkida Kapa”.
17. **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës financiare për Z.Rexhep Durmishi”.
18. **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës financiare për Z.Ylli Sinani”.
19. **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës financiare për Z.Përparim Mema”.
20. **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës financiare për Z.Agron Kocali”.

Komisioni për shqyrtim: Komisioni i ekonomisë.(pikat 12-20).

Afize Sula: Para se ta hedhim në votim pika 11 e rendit të ditës projekt vendimi dhe relacioni janë identike totalisht të njëjtë. Projekt vendimi ka tjetër strukturë dhe këtë e di secili këshilltarë. Nuk kuptoj se çfarë duhet të votojmë . Unë propozoj të hiqet nga rendi i ditës dhe të sillet i saktë në mbledhjen tjetër.

Esmerald Xhemali: Në lidhje me këtë propozim kam një pyetje: A janë mbledhur komisionet? Tjetrën e kam me Kryesinë: A janë filtruar nga ana juaj materialet e ardhura? Bëjmë të njëjtat debate në çdo mbledhje, materiale të pa plota.

Erjon Sinanaj: Në lidhje me Kryesinë është bërë një rend paraprak ku janë hequr dy materiale se kështu u pa e arsyeshme . Ju keni të drejtë ta votoni me ndryshime apo pa ndryshime.

Esmerald Xhemali: Shqetësimi tjetër për disa projekt vendime që duhet të kalojnë në më shumë se një komision nuk duhet të vendosë kryesia , kalimin në komisione. Unë propozoj të hiqet nga rendi i ditës dhe pika 10 e rendit të ditës, dokumentacioni jo i plotë të shoqërohet me projekt dhe preventivi e letrës.

Afize Sula: Edhe unë i bashkohem propozimit të Esmeraldit.

Asqeri Muçoima: Komisioni i integritetit u mbledh duke parë relacionin , projekt vendimin tani po e shoh. Ne si komision i dhamë ok.

Vjen në mbledhje Bujar Mamaj.

Afize Sula: Jam kundër mirëkuptimit të vazhdueshëm ndaj administratës për çështje standardi.

Petrit Lumani:Edhe unë dua të shpreh për projekt vendimin që kemi lënë në qershor dhe dhjetor siç tha këshilltarja , ka edhe ndjeshmëri qytetare. Unë nuk kundërshtoj dhe shpreh mendimin tim mos jam nxituar.2. Problemi që ngriti Afizeja dakord e kthejmë ,dua të merremi vesh karshi këtij problemi.

Hidhet në votim propozimi i Afize Sulës për heqjen e pikës 11 nga rendi i ditës.

Vota Pro 5 vota. Afize Sula, Erjon Sinanaj, Bujar Mamaj, Arsola Muzha, Esmerald Xhemali.

Vota Kundër 2 vota. Lauresha Lila, Flamur Mushamatit.

Vota Abstenim 3 vota. Asqer Muçoima, Anest Halili, Petrit Lumani. Miratohet.

Vjen në mbledhje Edmonda Harizi dhe Irena Jaupi.

Hidhet në votim propozimi i Esmerald Xhemalit për heqjen e pikës 10 të rendit të ditës.

Vota Pro 7 vota.

Vota Kundër 2 vota.Lauresha Lila, Flamur Mushamatit.

Vota Abstenim 3 vota. Asqer Muçoima, Anest Halili, Petrit Lumani. Miratohet .

Hidhet në votim rendi i ditës me ndryshime.

1. Miratimi i rendit të ditës së mbledhjes.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 27,02.2026.

Adresa: Bashkia Memaliaj, Rruga “Tafil Buzi” godina nr 7- Kodi Postar 6302 www.memaliaj.gov.al e-mail:info@bashkiamealiaj.gov.al

2

3. Informacion mbi vendimet e datës 27.02.2026.
4. **Analizë nga Sektori i Emergjencave Civile pranë Bashkisë:** "Raportim mbi përballimin e emergjencave gjatë vitit 2025 si dhe masat e marra për vitin 2026".
5. **Drejtoria e financës:** "Raportim mbi realizimin e buxhetit të vitit 2025".
6. **Auditi i brendshëm:** Raporti i auditimit për vitin 2024.
7. **Projekt vendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike (fondi i kushtëzuar 6% i bllok-ndihmës ekonomike) për muajin shkurt 2026".
Komisioni për shqyrtim: Komisioni i mirëqenies sociale.
8. **Projekt vendim:** "Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin mars 2026".
Komisioni për shqyrtim: Komisioni i mirëqenies sociale.
9. **Projekt vendim:** "Për miratimin e marrjes me qera të një ambienti për shërbime në funksion të të moshuarve".
Komisioni për shqyrtim: Komisioni i mirëqenies sociale.
10. **Projekt vendim:** "Për dhënie ndihmë financiare Z.Sokol Lulo".
11. **Projekt vendim:** "Për dhënien e ndihmës financiare për Z.Laert Kasemi".
12. **Projekt vendim:** "Për dhënien e ndihmës financiare për Znj.Idajete Dedgjoni".
13. **Projekt vendim:** "Për dhënien e ndihmës financiare për Z.Filip Çoka".
14. **Projekt vendim:** "Për dhënien e ndihmës financiare për Znj.Elkida Kapa".
15. **Projekt vendim:** "Për dhënien e ndihmës financiare për Z.Rexhep Durmishi".
16. **Projekt vendim:** "Për dhënien e ndihmës financiare për Z.Ylli Sinani".
17. **Projekt vendim:** "Për dhënien e ndihmës financiare për Z.Përparim Mema".
18. **Projekt vendim:** "Për dhënien e ndihmës financiare për Z.Agron Kocali".
Komisioni për shqyrtim: Komisioni i ekonomisë. (pikat 12-20).

Vota Pro 10 vota.

Vota Kundër 0 vota.

Vota Abstenim 1 votë. Miratohet

Largohet nga mbledhja Znj. Edmonda Harizi.

Miratimin i procesverbalit të mbledhjes së kaluar datë 27.02.2026 .

Vota Pro 10 vota.

Vota Kundër 0 vota.

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

Në votim nuk mori pjesë Esmerald Xhemalit.

Pika 4 e rendit të ditës. Analizë nga Sektori i Emergjencave Civile pranë Bashkisë:
"Raportim mbi përballimin e emergjencave gjatë vitit 2025 si dhe masat e marra për vitin 2026". Relaton Z. Fejzi Zeka / Specialist i emergjencave sipas materialit bashkangjitur. Irena Jaupi: Në lidhje me Nj.A Luftinjë nuk dëgjova rastin e djegies së pyllit me pisha dhe varrezave në fshatin Martaloz. Tjetër në rrëshqitjet e dherave është dhe rruga e fshatit Martaloz është bërë 2 metra ulja dhe banesat kanë pësuar dëmtime nuk dëgjova akt konstatimi. Në vazhdim dua një informacion të detajuar për masat e marra për rrëshqitjet e rrugës.

Asqeri Muçoima: Tek pika trajtim apo trajmin për stafin? Ju si bashki çfarë masash keni marrë për përmytet nga lumi në Qesarat?

Fejzo Zeka: Është trajnim, është lapsus në material. Ndërsa shqetësimi për fshatin Qesarat është bërë relacioni i detajuar dhe është dërguar në prefekturë. Jemi në pritje të vlerësimit të tyre.

Xhevit Kacorri: Këto informacione kam kërkuar unë. Ato shtëpitë e fshatit Memaliaj duan investim jo mbështetje morale. Do të thosha na mori mali në më të poshtë pa le lumi. Aty rrezikohet dhe një investim përveç banesësës. dua të di ç'do të bëj bashkia për këtë rast?

Flamur Mushamati: Përmbajtja është tjetër gjë rrëmbimi i lumit është tjetër gjë.

Vjen në mbledhje Z.Taulant Rama dhe Anest Halili.

Petrit Lumani: Me sa shoh këtu problemet janë te komisionet, jo te kryesia.

Esmerald Xhemali: Unë kam një pyetje: A ka qenë ky material në dosje kur kryesia e ka futur në rend dite.

Xhevit Kacorri: Unë propozoj të dëgjojmë zotërinë të relatoj.

Flamur Mushamati: Ne e miratim rendin e ditës ta dëgjojmë relatorin.

Relaton Besnik Caushi sipas relacionit bashkëngjitur.

Asqeri Muçoima: Pse nuk është realizuar buxheti në 100%? Dëgjova në qytet Memaliaj mbledhja e të ardhurave 105% dhe në fshatra 75%. Pse kjo diferencë?

Besnik Caushi: Përveç ngritjes së punës është dhe ardhja e emigrantëve nëpërmjet njoftimeve të bëra disa zëra e kanë tejkaluar dhe kanë kompensuar një-tj.

Xhevit Kacorri: Të gjitha bizneset këtu paguajnë? Sa janë të ardhurat nga bizneset?

Bujar Mamaj: Sa biznese ka të paregjistruar?

Asqeri Muçoima: Pse nuk ma dhe përgjigjen e pyetjes?

Besnik Caushi: Janë të ngelura nga viti i kaluar, nga blerja e një betoniere që su ble vitin e kaluar.

Auditi i brendshëm: Raporti i auditimit për vitin 2024.

Relaton Z. Fredi Kalemii për të sqaruar përgjigjen. Unë si audit relatoj vetëm para titullarit të bashkisë.

Xhevit Kacorri: Kjo shkresë duhet të grisej nuk mund të futej këtu. Esmerald Xhemali: Në shkresë citohet njësi është e pavarur dhe raporton vetëm te titullarit i institucionit. Ministria e financave na ka tërhequr vëmendjen neve si këshill për mos ushtrimin e detyrës sonë si këshilltarë për të kontrolluar administratën.

Taulant Rama: Ka një mosnjohje të këshillit nga administrata, por kryetari e ka detyrim obligativ nga ligji që të raportojë para këshillit. Unë propozoj ta ndërpresim mbledhjen.

Xhevit Kacorri: Sekretare mos na sill materiale pa firmën e titullarit në këshill. Ndihej i fyer se kam 2 vjet që kërkoj me shkrim nga audit, informacion çfarë bëhet në bashki.

Kryetari kërkon 5 min pushim.

Largohet nga mbledhja Z.Taulant Rama.

Fillon mbledhja.

Pika 7 e rendit të ditës: **Projekt vendim:** "Për dhënie e ndihmës ekonomike (fondi i kushtëzuar 6% i bllok-ndihmës ekonomike) për muajin shkurt 2026". Relaton znj. Laora Hoxha sipas relacionit bashkëngjitur.

Kalohet në votim:

Vota Pro: 9 vota.

Vota Kundër: 0 vota.

Vota Abstenim: 0 vota. Miratohet.



4

Pika 8 e rendit të ditës: **Projekt vendim:**“Për dhënien e ndihmës ekonomike për përdorimin e fondit të bashkisë për familjet që do të trajtohen me ndihmë ekonomike për muajin mars 2026”.
Relaton znj. Laora Hoxha sipas relacionit bashkëngjitur.
Kalohe në votim:

Vota pro: 9 vota.

Vota kundër: 0 vota.

Vota abstenim: 0 vota.Miratohet.

Largohet znj. Afize Sula.

Pika 9 **Projekt vendim:**“Për miratimin e marrjes me qera të një ambienti për shërbime në funksion të të moshuarve”.

Relaton znj. Laora Hoxha sipas relacionit bashkëngjitur.

Xhevit Kacorri : Kjo është draft kontratë 20 mijë lekë të vjetra.

Esmerald Xhemali: Kemi kërkuar draft-kontratën që të plotësohet dhe vlera, sepse herën e kaluar në relacion ishte 10.000 lekë/muaj, kurse këtu thotë 20.000 lekë.

Për këtë arsye kemi kthyer draftin për afat dhe shumë.

Erjon: Kur kalojmë shkollat janë 1-vjeçare dhe kjo të jepet me afat 1-vjeçar.

Xhevit Kacorri: Unë propozoj të jetë 2-vjeçare sepse kemi një vit zgjedhor përpara.

Asqeri Muçoima: Jam për një afat 2-vjeçar.

EsmeraldXhemali: Unë kam një kërkesë tjetër që të ofrohet edhe interneti.

Hidhet në votim me ndryshimet e propozuara:

Vota pro: 8 vota.

Vota kundër: 0 vota.

Vota abstenim: 2 vota. (A. Halili, B. Mama).

Pika 10 Kalohe në votim bllokë pikat 10 deri në 18.

1. **Projekt vendim:** “Për dhënie ndihmë financiare Z.Sokol Lulo”.

2. **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës financiare për Z.Laert Kasemi”.

3. **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës financiare për Znj.Idajete Dedgjoni”.

4. **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës financiare për Z.Filip Çoka”.

5. **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës financiare për Znj.Elkida Kapa”.

6. **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës financiare për Z.Rexhep Durmishi”.

7. **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës financiare për Z.Ylli Sinani”.

8. **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës financiare për Z.Përparim Mema”.

9. **Projekt vendim:** “Për dhënien e ndihmës financiare për Z.Agron Kocali”.

Esmerald Xhemali: Për Filip Çokën është lënë 30.000 lekë, nga të gjithë këta është më e nevojtar, unë propozoj të barazohet.

Kryetari: Një përgjigje mbi kërkesën e Esmeraldit.

Esmerald Xhemali: Unë them se është e mundësia ta rivendosë e shoh në planin social për këtë çështje.

Besnik Caushi: Bashkia ka bërë një program deri tani janë harxhuar gjysmat.Ok, pranohet.

Hidhen në votim bllok pikat 10 deri në 18.

Vota pro: 9 vota.

Vota kundër: 0 vota.

Vota abstenim: 1 vota. (A. Halili).Miratohet.



Kërkesa–ankesa nga Z. Erand Hetemi.

Për vendimin nr. datë 29.11.2025. " Emërtim rruge në fshatin Gllavë "Neim Cena".

Erjon Sinanaj: Ju vë ndijeni me kërkesën.

Flamur Mushamati: Mua më duket pak tendencioze.

Erjon Sinanaj: Juriste duam të na njohësh me procedurat që ndiqen për këtë rast.

Esmerald Xhemali: Për dijeni kjo kërkesë e duhet ti shkojë dhe shoqatës një kopje. Po ka vendim gjykate që është dënuar për vjedhje le ta sjelli. Meqë ndodhi kjo unë kam një propozim lidhur me titujt e nderit duhet ti bashkohen dokumenta si dëshmi penalitet, pastërtia e figurës etj.

Asqeri Muçoima:Ti kërkohet zyrës që solli relacioni të gjitha këto dokumenta.

Esmerald Xhemali: Propozoj ngritjen e komisionit të përkohshme për:

Kontrollin e praktikës së Ujësjetësit që nga nga prokurimi deri në vazhdim.

Bujari Mamaj Propozime komision për kontrollin e Drejtorisë së Tatim-Taksave për vitet 2024–2025.

Xhevit Kacorri: Propozon komision për njohjen me raportin e auditimit të brendshëm për vitin 2024 dhe 2025.

Afati i komisioneve: 6 muaj.

Komisioni I

1. Petrit Lumani propozon Esmerald Xhemalin.
2. Asqeri Muçoima propozon Petrit Lumanin.
3. Esmerald Xhemali propozon Bujar Mamajn.
4. Arsola Muzha propozon Asqeri Muçoimën.
5. Erjon Sinanaj propozon Arsola Muzhën.

Komisioni përbëhet nga :

1. Esmeralda Xhemali – Kryetar
2. Asqeri Muçoima
3. Bujar Mamaj
4. Petrit Lumani – Sekretar
5. Arsola Muzha

Kalohet në votim:

Vota pro: 9 vota.

Vota kundër: 0 vota.

Vota abstenim: 0 vota. Miratohet.

Komisioni II

Propozohen këta emra për kryetar dhe anëtarë.

1. Arsola Muzha propozon Esmerald Xhemalin.
2. Petrit Lumani propozon Arsola Muzhën.
3. Erjon Sinanaj propozon Bujar Mamajn.
4. Flamur Mushamati propozon Lauresha Lilën.
5. Xhevit Kacorri propozon Petrit Lumanin

Komisioni përbëhet nga:

1. Esmeralda Xhemali
2. Arsola Muzha – Sekretar
3. Bujar Mamaj– Kryetar
4. Lauresha Lila
5. Petrit Lumani

Kalohet në votim:



[Handwritten signatures and initials in blue ink, including names like 'Asqeri Muçoima', 'Bujar Mamaj', and 'Esmerald Xhemali'. A small number '6' is visible at the bottom right of the signatures.]

Vota pro: 9 vota

Vota kundër: 0 vota.

Vota abstenim: 0 vota.

Komisioni III

Komisioni për njohjen me raportin e auditimit të brendshëm për vitet 2024 dhe 2025.

1. Petrit Lumani propozon Xhevit Kacorri.
2. Asqeri Muçoima propozon Bujar Mamën
3. Arsola Muzha propozon Esmerald Xhemalin

Përbërja e komisionit:

Xhevit Kacorri – Kryetar

Bujar Mamaj – Sekretar

Esmeralda Xhemali

Hidhet në votim Komisioni.

Vota Pro 9 vota .

Vota Kundër 0 vota.

Vota Abstenim 0 vota. Miratohet.

Kryetari e deklaron mbledhjen të mbyllur.

Këshilltarë pjesëmarrës.

1. Flamur Mushamati
2. Asqeri Muçoima
3. Bujar Mamaj
4. Petrit Lumani
5. Lauresha Lila
6. Arsola Muzha
7. Xhevit Kacorri
8. Esmerald Xhemali
9. Edmonda Harizi
10. Afize Sula
11. Irena Jaupi
12. Anest Halili
13. Taulant Rama
14. Erjon Sinanaj



Sekretar i këshillit

Erjola Allka

Kryetari i këshillit

Erjon Sinanaj

